



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 mars 2023
Nr. Ref.:RK 2142/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI89/22

Parashtrues

Xhelal Plakolli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit Pml.nr. 88/22 të 21 marsit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Xhelal Plakolli me vendbanim në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Jeton Osmani, avokat nga Komuna e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 88/22] të 21 marsit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [PA1.nr.561/2021] e 4 nëntorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [P.nr.1239/2019] e 23 prillit 2021 të Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe te Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, nenet 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe shkeljet e neneve 9, 10 dhe 11 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.
4. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kërkon vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht kërkon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit të tij.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 56 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 22 qershor 2022.
7. Më 23 qershor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR.KI89/22] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 30 qershor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi të dorëzojë kopjen e Aktgjykimit [Pml.nr. 88/22] të 21 marsit 2022, të Gjykatës Supreme dhe autorizimin e përfaqësuesit ligjor para Gjykatës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 14 korrik 2022, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës kopjen e Aktgjykimit [Pml.nr. 88/22] të 21 marsit 2022 dhe autorizimin e përfaqësuesit ligjor.
10. Më 15 nëntor 2022, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës një shkresë urgjente me të cilën përsërit kërkesën para Gjykatës që të caktojë masën e përkohshme për shtyrje të ekzekutimit të Aktgjykimit [Pml.nr. 88/22] të 21 marsit 2022 deri në vendosjen meritore të çështjes *“...pasi qe kjo eshte e domosdoshme për te evituar rrezikun qe parashtruesi i kësaj kërkesë te dërgohet ne vuajtje te dënimit dhe me këtë t'i shkaktohet dëm i pariparueshme duke ju cenuar liria e tij, e që është interesi publik qe te mbroje qytetaret tone nga burgosja arbitrare”*.
11. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
12. Më 7 mars 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 7 nëntor 2016, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti Aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës, në dyshimin e bazuar se kishte kryer veprën penale të mashtrimit e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 335 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK). Parashtruesi i kërkesës në esencë akuzohej se pasi që, më 10 nëntor 2011, ishte autorizuar nga B.L, që në emër të tij të ndërmerre të gjitha veprimet për shitjen e një prone e cila gjendej në parcelën kadastrale nr.945/1, certifikata poseduese nr. UL-72217092-02192 ZK-Ferizaj, me sipërfaqe prej 214 m² (në tekstin e mëtejme: prona nr. 945/1), ai kishte shitur pronën përmes kontratës së shitblerjes më 4 janar 2012, ndërkaq mjetet e realizuara nga kjo shitje nuk ia kishte dhënë personit B.L., sipas marrëveshjes.
14. Më 30 maj 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr.1077/2016] shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të mashtrimit e paraparë me paragrafin 2 të nenit 335 (Mashtrimi) të KPRK, dhe e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe me gjobë në vlerë prej 1000 (një mijë) euro. Po ashtu, Gjykata Themelore udhëzoi të dëmtuarin B.L për realizimin e kërkesës së tij pasurore në kontest civil.
15. Më 21 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës theksoi se *“Cilësimi juridik ndaj tij është i gabuar dhe i paqëndrueshëm”*.
16. Më 10 shtator 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PA1.nr.895/2019] anuloi Aktgjykimin [P.nr.1077/2016] e Gjykatës Themelore, të 30 majit 2019 dhe çështjen e ktheu në rigjykim. Në arsyetim të aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi se dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte kontradiktor ne mes vete si dhe me arsyetimin e tij. Gjykata e Apelit më tej theksoi se gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të saj nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë faktet që i konsideron dhe arsyet pse i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, dhe në këtë drejtim Gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar t'i vlerësojë provat një nga një, saktësinë e tyre, dhe arsyet në të cilat është bazuar në zgjidhjen e rastit në aspekt të vërtetimit të ekzistimit ose mos ekzistimit të veprës

penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit. Po ashtu, Gjykata e Apelit shtoi se Gjykata Themelore nuk kishte precizuar veprimet inkriminuese të parashtruesit të kërkesës.

17. Më 23 prill 2021, Gjykata Themelore në procedurë të rigjykimit përmes Aktgjykimit [P.nr.1239/2019] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të mashtrimit e paraparë me paragrafin 2 të nenit 335 të KPRK-së, duke e dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve si dhe dënim me gjobë në vlerë prej 1,000 (një mijë) eurove. Pas analizimit të provave dhe dëgjimit të palëve në procedurë si dhe dëshmime të dëshmitarëve, Gjykata Themelore konstatoi që në veprimet e parashtruesit të kërkesës ekzistojnë elementet e kryerjes së veprës penale për të cilën ishte akuzuar. Po ashtu, Gjykata Themelore udhëzoi të dëmtuarin B.L për realizimin e kërkesës së tij pasurore në kontest civil.
18. Nga Aktgjykimi [P.nr.1239/2019] i 23 prillit 2021, të Gjykatës Themelore rezulton që:
 - 1) në emër të realizimit të kontratës së shitblerjes për pronën e lartcekur, blerësi D.R. realizoi këstin e parë të parashtruesi i kërkesës, në vlerë prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro para kesh dhe 10,000 (dhjetë mijë) euro të tjera duke ia dhënë veturën e tipit Opel Vectra, të dyja të barasvleshme në total me shumën prej 20,000 (njëzet mijë) euro, ndërsa më 8 maj 2012 dhe 10 maj 2012, këstin e dytë e realizoi përmes transferit bankar në vlerë totale prej 20,000 (njëzet mijë) euro;
 - 2) prona nr. 945/1 ishte e uzurpuar nga F.A., andaj, më 11 maj 2012, parashtruesi i kërkesës përmes bankës transferoi shumën prej 6,000 (gjashtë mijë) euro te F.A. në emër të liritimit të pronës, dhe po ashtu, për të njëjtën arsye, blerësi D.R. përmes bankës transferoi te F.A. shumat prej: 3,000 (tre mijë) euro më 21 maj 2012, dhe repektivisht 1,000 (një mijë) euro më 2 qershor 2012;
 - 3) më 25 nëntor 2014, në prezencë të dëshmitarit R.S., parashtruesi i kërkesës lidhi marrëveshje me kohë të caktuar me B.L. ashtu që t'ia përmbushë detyrimin deri më së largu me 30 mars 2015, e cila nuk është realizuar.
19. Më 1 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të shkallës së parë duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal.
20. Më 5 nëntor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.561/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke vërtetuar në plotni Aktgjykimin [P.nr.1239/2019] e Gjykatës Themelore, të 23 prillit 2021.
21. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit [P.nr.1239/2019] të 23 prillit 2021, të Gjykatës Themelore si dhe Aktgjykimit [PA1.nr.561/2021] të 5 nëntorit 2021, të Gjykatës Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës në esencë në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pretendoi se në veprimet e tij nuk plotësoheshin elemente e veprës penale për të cilën ishte akuzuar.
22. Më 21 mars 2022, Gjykata Supreme e Kosovës përmes Aktgjykimit [Pml.nr.88/2022] aprovoi pjesërisht kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, përkritazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimit mbi dënimin. Gjykata Supreme konsideroi se në veprimet e parashtruesit të kërkesës ishin përmbushur elementet e kryerjes së veprës penale

“keqpërdorim i besimit” e paraparë me paragrafin 1 të nenit 269 (Keqpërdorimi i besimit) të KPRK-së duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj. Gjykata Supreme në arsyetim të aktgjykimit të saj, konsideroi se gjykatat e instancave më të ulëta kanë paraqitur pasqyrë të qartë lidhur me rastin, megjithatë Gjykata Supreme vlerësoi se në rastin konkret nuk është argumentuar elementi esencial i veprës penale të mashtrimit, respektivisht, “*vënia në lajthitje të të dëmtuarit dhe cilat ishin faktet e rrejtshme të prezentuara nga ana e tij, ashtu që nga kjo arsye, kjo gjykatë bëri ricilësimin e kualifikimit juridik të veprës penale*”. Lidhur me vendimin mbi dënimin Gjykata Supreme pasi rikualifikoi veprën penale, për të cilën si dënim është paraparë dënimi me burgim apo me gjobë, largoi dënimin me gjobë për parashtruesin e kërkesës dhe e vërtetoi pjesën tjetër të dënimit, respektivisht, dënimin me burgim për parashtruesin e kërkesës në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve dhe udhëzimin e të dëmtuarit B.L. për realizim të kërkesës pasurore në kontest civil.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkëlur të drejtat e tij të garantuar me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, nenet 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
24. Parashtruesi i kërkesës së pari thekson se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është “*vendim i cili në kohën kur është marrë dhe në kohën kur është shqiptuar dënimi me burgim ndaj paraqitësit të kësaj kërkesë për kryerjen e veprës penale Keqpërdorimi i Besimit të paraparë nga neni 269 par. 1 të KPRK-së vepra penale ka qenë e parashkruar në mënyrë absolute [...] lidhur me veprën penale të lartcekur kemi pas parashkrim absolut edhe në kohën kur Gjykata Themelore në Ferizaj ka marrë aktgjykimin Pnr.1239/2019 dt.23.04.2021 dhe atë të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.561/2021 të dt.04.11.2021, andaj edhe në këtë kuptim të kësaj edhe këto vendime duhet të konsiderohen të kundërligjshëm në kuptim të lartcekurave dhe të gjeturave të Gjykatës Supreme*”.
25. Më tej, parashtruesi i kërkesës shton se “[...] Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka qenë jo i drejt dhe se Gjykata Supreme me rastin e konstatimit të ekzistimit të veprës penale Keqpërdorimi i Besimit të parapare nga neni 269 par.1 të KPRK-së është dashur që ta Hedhë në tërësi aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj e kjo nga fakti se lidhur me veprën për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim, ka arritur parashkrimi absolut i veprës së lartcekur penale në kuptim të dispozitës së nenit 90. par.1 pika 5 dhe 91 par.6 të KPPR (kodit të përkohshëm penal të Kosovës) lidhur me veprën penale nga neni 269 par.1 të KPPR pasi që ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale) i parapare për ndjekjen e veprës penale”. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se “[...] për parashkrim sipas detyrës zyrtare duhet të kujdeset vet gjykata gjatë vendosjes si dhe gjatë udhëheqjes së tërë procedurës penale.”
26. Lidhur me rikualifikimin e veprës penale, parashtruesi i kërkesës gjithashtu shton para Gjykatës se përgjatë procedurës penale të zhvilluar kundër tij, i njëjti nuk ka pasur mundësi që të mbrohet për veprën penale të “keqpërdorimit të besimit”, pasi që mbrotjtja e tij ka qenë

e përcaktuar për veprën penale të “*mashtimit*”, dhe se në këtë rast pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve sepse sipas tij ky parim “*shprehet në të drejtën e palëve për të pasur njohuri dhe për të komentuar provat e paraqitura apo vërejtjet e parashtruara në çdo kohë dhe në çdo fazë të gjykimit, e që në rastin konkret kanë munguar*”. Në ndërlidhje me këtë parashtruesi i kërkesës shton se i është shkelur edhe neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] sepse sipas tij, atij i ishte mohuar e drejta për t’u ankuar me rastin e rikualifikimit të veprës penale.

27. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se: “*Gjykata Supreme ashtu edhe Gjykata e Apelit kanë vendosur për raste të ngjashme si të paditesit duke i ndryshuar ato, me ç’rast Gjykatat e rregullta kanë krijuar qendrime të ndryshme për raste të ngjashme si të paraqitesit të kesaj kerkese dhe me kete edhe kanë krijuar pasiguri juridike, andaj edhe në kuptim të kesaj të denuarin e ka vene në pozite të pabarabarta para ligjit në kuptim të nenit 24 të Kushtetutes se Kosoves pasi qe të gjithë jane të barabarte para ligjit dhe se çdokush gezon të drejten e mbrojtjes se barabarte ligjore, pa diskriminim*”.

Kërkesa për masë të përkohshme

28. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij para Gjykatës kërkoi nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme me arsyetimin si në vijim: “*Gjykata Themelore në Ferizaj veçse ka lëshuar urdhëresën për ekzekutimin e vendimit të atakuar përmes Urdhëresës ED.nr.36/2022 dt.08.06.2022 dhe meqenëse paraqitësi i kesaj kerkese konsideron se kemi të bëjmë me një aktgjykim i cili e gjykon të njëjtin me Dënim me burg për kryerjen e kesaj vepre që në kohën e gjykimit ka qenë absolutisht e parashkruar, konsiderojmë se është mëse e domosdoshme qe ekzekutimi i ketij aktgjykimi të ndalohet deri në vendosje nga kjo Gjykatë lidhur me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.nr.88/2022 dt.21.03.2022.*”
29. Më 15 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës po ashtu dorëzoi para Gjykatës shkresën “*URGJENC Për marrje të vendimit për masën e sigurisë*”, me kërkesën si në vijim: “[...] *kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që të vendos përkohësisht MASËN e PËRKOSHME duke ndaluar ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.nr/88/2022 të dt.21.03.2022 pasi që kjo është e domosdoshme për të evituar rrezikun që parashtruesi i kesaj kerkese të dërgohet në vuajtje të dënimit dhe me këtë t’i shkaktohet dëm i pariparueshëm duke ju cenuar liria e tij, e që është interesi publik që të mbrojtë qytetarët tonë nga burgosja arbitrare*”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”

Neni 29
[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

“1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në

mënyrën e përcaktuar me ligj;

[...]

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

3. Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.”

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

Neni 102
[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

- “1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.
2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankesë.”

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për gjykim të drejtë)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë [...]”

Neni 7 (Nuk ka dënim pa ligj)

“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale. [...]”

Neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive)

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

KODI I PËRKOZHSHËM PENAL I KOSOVËS

Neni 90 Parashkrimi i ndjekjes penale

*“(1) Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme:
[...]*

*4) Pesë vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet burgim;
5) Tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim
[...].”*

Neni 91

Fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale

“(1) Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale.

(2) Afati i parashkrimit nuk rrjedh për kohën gjatë të cilës ndjekja nuk mund të fillohet apo të vazhdohet sipas ligjit.

(3) Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer.

(4) Afati i parashkrimit ndërpritet po ashtu kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit.

(5) Pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.

(6) Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).”

Neni 261

Mashtrimi

“(1) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtyt personin e tillë që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili e tejkalon shumën prej 15,000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.”

Neni 269

Keqpërdorimi i besimit

“(1) Kushdo që gjatë përfaqësimit të interesave pronësore të personit tjetër ose kujdesjes për pasurinë e tij nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo ta dëmtojë personin interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen kujdestari apo avokati, kryerësi dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.”

KODI I PROCEDURËS PENALE TË KOSOVËS

Neni 407

Ankesa në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit

“1. Ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ose Gjykatës së Apelit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm.[...]”

Neni 432

Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

“1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

- 1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;*
- 1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose*
- 1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. [...]*”

Neni 435

Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga kolegji i Gjykatës Supreme

“1. Për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë vendos Gjykata Supreme e Kosovës në seancë të kolegjit. [...]”

Neni 436

Favoret e të pandehurit përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

“1. Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon. [...]”

Neni 438

Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

“1. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

- 1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;*
- 1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më të lartë dhe lëndën për vendim të ri ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose*
- 1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.[...]”*

Neni 485

Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimit

“1. Aktgjykimi merr formë të prerë kur më nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë.”

2. Aktgjykimi i formës së prerë ekzekutohet kur është bërë dorëzimi dhe kur për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore. Në qoftë se nuk është parashtruar ankesë ose palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë apo janë tërhequr nga ankesa e parashtruar, aktgjykimi konsiderohet i ekzekutueshëm pas kalimit të afatit për ankesë apo nga dita e heqjes dorë ose e tërheqjes së ankesës.”

**QËNDRIMI PARIMOR [AG.NR. 314/2012], I 10 SHTATORIT 2012, I
GJYKATËS SUPREME
përcaktoi:**

Ekzekutimi i dënimit me burgim nuk mund të fillojë, nëse ka arritur afati absolut i parashkrimit; gjithashtu dënimi nuk mund të vazhdojë të ekzekutohet, nëse gjatë mbajtjes së dënimit është arritur afati absolut i parashkrimit të dënimit

“Nëse parashkrimi ka ndodhur para se aktgjykimi të jetë bërë i plotfuqishëm, atëherë duhet konsideruar së është fjala për parashkrim të ndjekjes penale.

[...]

Për përcaktimin e afatit të parashkrimit gjithmonë vendimtar është dënimi i shqiptuar me aktgjykim të plotfuqishëm dhe jo ndryshimet e mëpastajme, të cilat mund t'i bëhen dënimit përmes amnistisë dhe faljes”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Gjithashtu, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 47 (Kërkesat individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, si dhe në rregullin 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: palë e autorizuar; konteston Aktgjykimin [Pml.nr. 88/22] e 21 marsit 2022, të Gjykatës Supreme të Kosovës; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkëlur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton që:
- "(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*
35. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20, parashtrues Sadik Gashi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, parashtrues Kujtim Lleshi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; KI21/21, parashtrues, Asllan Meka, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021, KI107/21, parashtrues Ramiz Hoti, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).

36. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Aktgjykimin [Pml.nr. 88/22] e 21 marsit 2022, të Gjykatës Supreme, përmes të cilit Gjykata Supreme ndërroi cilësimin juridik të veprës penale dhe ndryshoi vendimin mbi dënimin për parashtruesin e kërkesës më ç'rast e rikualifikoi veprën penale për të cilën ishte shpallur fajtor nga gjykatat e rregullta nga vepra penale e "Mashttrimi" në veprën penale të "Keqpërdorimit të besimit" si dhe largoi dënimin me gjobë, duke lënë në fuqi vetëm dënimin me burgim prej 10 (dhjetë) muajve. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes rikualifikimit juridik të veprës penale, Gjykata Supreme e ka dënuar për vepër penale e cila ka arritur parashkrimin absolut në kuptim të pikës 5 së paragrafit 1 të nenit 90 dhe paragrafit 6 të nenit 91 Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), lidhur me veprën penale të "Keqpërdorimit të besimit" pasi që ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale) i paraparë për ndjekjen e veprës penale, si dhe konsideron se për shkak të rikualifikimit të veprës penale nga Gjykata Supreme i është mohuar e drejta për t'u ankuar dhe parashtruar argumente kundër veprës penale për të cilën është dënuar, me ç'rast pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, dhe nenin 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së. Gjithashtu, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit kanë krijuar qëndrime të ndryshme për raste të ngjashme duke krijuar pasiguri juridike dhe vendosur në pozitë të pabarabartë parashtruesin e kërkesës në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës.
38. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit, të ngritura në kërkesë, ka të bëjë me: i) parashkrimin absolut të veprës penale për të cilën është dënuar pas rikualifikimit të saj, gjegjësisht, shkeljen e neneve 31 dhe 33 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së; ii) pamundësinë e tij për t'u ankuar dhe parashtruar argumente kundër kësaj vepre penale, respektivisht, shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së; dhe iii) mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe të Apelit për rastet e ngjashme, si dhe shkeljen e neneve 3, 24, dhe 31 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, në vijim, Gjykata do t'i shqyrtojë ndaras këto pretendimet të parashtruesit të kërkesës.

I. Përkitazi me pretendimet për parashkrimin e veprës penale, gjegjësisht, shkeljen e neneve 31 dhe 33 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së

39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se është dënuar për vepër penale e cila ka arritur parashkrimin absolut në kuptim të pikës 5 së paragrafit 1 të nenit 90 dhe paragrafit 6 të nenit 91 KPPK, lidhur me veprën penale të "Keqpërdorimit të besimit" pasi që ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale) i paraparë për ndjekjen e veprës penale, për të cilin parashkrim Gjykata Supreme do të duhej të kujdesej sipas detyrës zyrtare. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës konsideron se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së.

40. Gjykata vëren se thelbi i pretendimit të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me aplikimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga gjykatat e rregullta, përkatësisht të dispozitave të KPPK dhe KPPRK në lidhje me institutin juridik të parashkrimit.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se është arritur parashkrimi absolut për veprën penale për të cilën është dënuar, i ngritur në kuptim të neneve 31 dhe 33 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së bie në kategorinë e pretendimeve “*të shkallës së katërt*”, sepse ndërthhen çështje që ndërlidhen me interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht “*ligjshmërisë*” dhe jo “*kushtetutshmërisë*”.
42. Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “*kushtetutshmërisë*” dhe “*ligjshmërisë*” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues Belgjyzar Latifi, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, parashtruese Lumturije Murtezaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues, Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues Qemajl Babuni, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
43. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, rast i cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, rast cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues Qemajl Babuni, rast i cituar më lart, paragrafi 35).
44. Gjykata mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës KI75/17, parashtrues X, Aktgjykim i 30 janarit 2018, paragrafi 59).
45. Në lidhje me institutin juridik të parashkrimit, Gjykata vë në pah praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ku parashkrimi përkufizohet si “[...] e drejtë ligjore e një shkelësi për të mos u ndjekur penalisht ose gjykuar pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore që nga kryerja e veprës. Afatet e parashkrimit, të cilat janë një tipar i përbashkët i sistemeve juridike të brendshme të Shteteve Kontraktuese, shërbejnë për disa qëllime, të cilat përfshijnë sigurimin e sigurisë juridike dhe përfundimtare dhe parandalimin e shkeljeve të të drejtave të të pandehurve, të cilat mund të cenohen nëse gjykatave do t'u kërkohet të vendosin për baza e provave që mund të jenë bërë të paplota për shkak të kalimit të kohës (shih, rastet e GJEDNJ-së, Coeme dhe të tjerët kundër Belgjikës, 32492/96, 32547/96, 32548/96,

33209/96 dhe 33210/96, Aktgjykim i 22 qershorit 2000, paragrafi 146, *Stubbings dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 22083/93; 22095/93, Aktgjykim i 22 tetorit 1996). Nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së rezulton se parashkrimi është specifik në sistemet juridike të brendshme të Shteteve Kontraktuese. Për ilustrim, në të drejtën penale belge, klasifikimi i një veprë penale përcaktohet jo sipas dënimit të zbatueshëm, por sipas dënimit që është aplikuar në të vërtetë. Prandaj, data e aktgjykimit duhet të jetë pikënisja për të përcaktuar se çfarë periudhe duhet të kalojë para se ndjekja penale të parashkruhet (shih rastin e GJEDNJ-së, *Coeme dhe të tjerët kundër Belgjikës*, rast i cituar më lart, paragrafi 147)

46. Gjykata vëren se instituti i parashkrimit të veprave penale në mënyrë të detajuar rregullohet në Kodin Penal të Përkohshëm të Kosovës, respektivisht, në nenet 90 dhe 91 të KPPK-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale në rastin konkret. Paragrafi 5 i nenit 90 të KPPK-së, përcakton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim, ndërsa paragrafi 6 i KPPK-së parasheh se *“Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).”*
47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme, të konsoliduar në arsyetimin e Qëndrimit parimor të saj [Ag.nr. 314/2012], të 10 shtatorit 2012, ku theksohet se: *“Për përcaktimin e afatit të parashkrimit gjithmonë vendimtar është dënimi i shqiptuar me aktgjykim të plotfuqishëm dhe jo ndryshimet e mëpastajme, të cilat mund t'i bëhen dënimit përmes amnistisë dhe faljes”*. Ky qëndrim po ashtu thekson se: *“Nëse parashkrimi ka ndodhur para se aktgjykimi të jetë bërë i plotfuqishëm, atëherë duhet konsideruar se është fjala për parashkrim të ndjekjes penale”*.
48. Në anën tjetër, neni 485 (Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria e vendimit) i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK) përcakton që: *“Aktgjykimi merr formë të prerë kur më nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë”*. Ndërsa, neni 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) i KPPRK përcakton se kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet e specifikuara me këtë nen.
49. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar mjet të jashtëzakonshëm juridik në Gjykatën Supreme, gjegjësisht, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PA1.nr.561/2021] e 4 nëntorit 2021 të Gjykatës së Apelit, i cili vendim është i formës së prerë. Si rezultat, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr. 88/22] të 21 marsit 2022, rikualifikoi veprën penale për të cilin parashtruesi i kërkesës është dënuar, respektivisht ndryshoi dënimin e tij nga vepra penale e *“Mashtrimit”*, të përcaktuar me nenin 261 të KPPK-së, në veprën penale *“Keqpërdorim i besimit”*, të përcaktuar me nenin 269 të po këtij kodi.
50. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah dispozitat e KPPRK, respektivisht paragrafin 1 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të saj, i cili përcakton se: *“1. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes: 1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë; 1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më të lartë dhe lëndën për vendim të ri ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose 1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit. [...]”*. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme

në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka juridiksion që të ndryshojë vendimin e formës së prerë, e me këtë rast edhe të rikualifikojë veprën penale.

51. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës, vendim i formës së prerë konsiderohet Aktgjykimi [PA1.nr.561/2021] i 4 nëntorit 2021 i Gjykatës së Apelit dhe se përmes mjetit të jashtëzakonshëm juridik, Gjykata Supreme ka ndryshuar vetëm kualifikimin e veprës penale, duke e ricilësuar veprën penale në dobi të parashtruesit të kërkesës, respektivisht, nga vepra penale e “*Mashtrimit*”, e dënueshme deri në 5 (pesë) vjet burgim, në veprën penale “*Keqpërdorim i besimit*”, e dënueshme deri në 3 (tre) vjet burgim, si dhe largoi dënimin me gjobë.
52. Gjykata më tej konsideron se Gjykata Supreme ka ofruar arsyetimin përkatës për rikualifikimin e veprës penale si në vijim: *“[...] konkludimet e dy gjykatave më të ulëta sa i përket provave të administruara që kanë të bëjnë me aplikimin e ligjit penal nuk janë të drejta dhe për këtë arsye, pikëpamjet e këtyre gjykatave sa i përket cilësimit juridik të vepres penale nuk i aprovoi Gjykata Supreme e Kosovës, për faktin se në rastin konkret nuk është argumentuar elementi esencial i vepres penale të mashtrimit - vënia në lajthim të të dëmtuarit dhe cilat ishin faktet e rrejshme të prezantuara nga ana e tij, ashtu që nga kjo arsye, kjo gjykatë bëri ricilësimin e kualifikimit juridik të veprës penale, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.”*
53. Po ashtu, Gjykata thekson se duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 435 (Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga kolegji i Gjykatës Supreme) të KPPRK-së në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 436 (Favoret e të pandehurit përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së, Gjykata Supreme vendos për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë në seancë të kolegjit dhe kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.
54. Gjykata vëren se sipas dispozitave ligjore në fuqi, ndjekja penale për një vepër penale mund të parashkruhet deri në momentin vendimit të formës së prerë, andaj, konstaton se nuk është detyrë e Gjykatës Supreme që të konstatojë parashkrimin në këto rrethana pasi që e njëjta ka juridiksion të kufizuar në çështjet që i trajton, përkatësisht, në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se në momentin kur vendimi ka marrë formë të prerë, respektivisht, në procedurën para Gjykatës së Apelit, e njëjta e ka dënuar për vepër penale tjetër, e për të cilën ndjekja penale nuk është parashkruar. Andaj, në rastin konkret nuk mund të dëshmohet që ka arbitraritet në aplikimin e ligjit nga gjykatat e rregullta. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, me rikualifikimin e veprës penale në dobi të tij, i njëjti ka përfituar.
55. Si përfundim, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij nuk ka arritur të dëshmojë dhe të mbështesë pretendimin e tij se si Gjykata Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së.
56. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për parashkrimin e veprës penale për të cilën është dënuar, respektivisht, shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së janë pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimet për shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së

57. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se përgjatë procedurës penale të zhvilluar kundër tij, i njëjti nuk ka pasur mundësi që të mbrohet për veprën penale të “keqpërdorimit të besimit”, pasi që mbrojtja e tij ka qenë e përcaktuar për veprën penale të “mashtrimit”, dhe se në këtë rast pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve sepse sipas tij ky parim “shprehet në të drejtën e palëve për të pasur njohuri dhe për të komentuar provat e paraqitura apo vërejtjet e parashtruara në çdo kohe dhe në çdo fazë të gjykimit, e që në rastin konkret kanë munguar”. Në ndërlidhje me këtë parashtruesi i kërkesës shton se i janë shkelur edhe nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] sepse sipas tij, atij i ishte mohuar e drejta për t’u ankuar me rastin e rikualifikimit të veprës penale.
58. Lidhur me pretendimin e shkeljes së parimit të barazisë së armëve, Gjykata fillimisht, Gjykata vë në pah se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së detyron gjykatat që të bëjnë shqyrtim të mirëfilltë të parashtrësive, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët dhe të vlerësojnë, pa paragjykim, nëse ato janë të rëndësishme dhe me peshë për vendimin e saj (shih rastin e GJEDNJ, *Kraska kundër Zvicrës*, nr. 13942/88, Aktgjykimi i 19 prillit 1993, paragrafi 30).
59. Një detyrim i tillë për gjykatat jetësohet, ndër të tjera, përmes zbatimit të parimit të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kuadër, GJEDNJ ka nënvizuar se parimi i barazisë së armëve është element i qenësishëm i konceptit më të gjerë të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm dhe është ngushtësisht i lidhur me parimin e kontradiktoritetit procedural (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Regner kundër Republikës Çeke*, nr. 35289/11, Aktgjykimi i 19 shtatorit 2017, paragrafi 146).
60. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilën e ka ndjekur me konsistencë edhe Gjykata Kushtetuese, është theksuar në vazhdimësi se parimi i barazisë së armëve kërkon “*ekuilibër të drejtë midis palëve*”, ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në pozitë të pafavorshme, gjegjësisht disavantazh thelbësor kundruall palës kundërshtare (shih rastet e GJEDNJ-së, *Yvon kundër Francës*, nr. 44962/98, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe *Dombo Beheer B.V. kundër Holandës*, nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33, *Feldbrugge kundër Holandës*, Aktgjykimi i 7 korrikut 1987, paragrafi 44, rastet Ofrer dhe Hopfinger kundër Austrisë, nr 524/59 dhe 617/59, 19.12.60, Vjetari 6, f. 680 dhe 696, shih dhe referencat tjera në këtë Aktgjykim, *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], nr. 46221/99, Aktgjykimi i 12 majit 2005, paragrafi 140; shih po ashtu rastet e Gjykatës, KI52/12, parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykimi i 5 korrikut 2013, KI103/10, parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykimi i 20 marsit 2012, paragrafi 40, KI193/19, parashtrues *Salih Mekaj*, Aktgjykimi i 31 dhjetorit 2020, paragrafi 44).
61. Duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, parimi i barazisë së armëve është i rëndësishëm sidomos në çështjet penale dhe ky parim zbatohet në të gjitha fazat e gjykimit, duke përfshirë edhe procedurën sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, siç është “kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë”. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet vendimit të GJEDNJ-së, në rastin *Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 21510/03, Aktgjykimi i 31 majit 2007. Në këtë rast, një kompani që ishte palë kundërshtare në procedurë me parashtruesin e kërkesës, sikundër edhe prokurori publik, kishin paraqitur ankesë përkatësisht “kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë” në Gjykatën Supreme, kundër një

vendimi të gjykatës së shkallës më të ulët. Pala tjetër (parashtruesi i kërkesës) nuk ishte njoftuar lidhur me atë kërkesë. Sipas GJEDNj-së, ankesa dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë çoi në vendimin e Gjykatës Supreme i cili ishte tërësisht i pafavorshëm ndaj palës tjetër (parashtruesit të kërkesës). Rrjedhimisht, GJEDNj-ja konsideroi se dështimi procedural për të njoftuar palën tjetër (parashtruesin e kërkesës) e ka penguar atë nga pjesëmarrja në mënyrë efektive në procedurë para Gjykatës Supreme. GJEDNj, më tutje, theksoi se *“respektimi i të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 6.1 të Konventës, kërkon që parashtruesi të ketë mundësinë që të ketë njohuri dhe të mund të komentojë apelin e kompanisë dhe kërkesën [për mbrojtje të ligjshmërisë] të prokurorit publik”*. (shih rastin e Gjykatës, KI193/19, rast i cituar më lart, paragrafi 45).

62. Gjykata përsëritë se Aktgjykimi [PA1.nr.561/2021] i 4 nëntorit 2021 të Gjykatës së Apelit është vendim i formës së prerë, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës është dënuar për veprën penale të *“Mashtrimit”*. Pas mashtrimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm në procedurën penale nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme ia ka rikualifikuar veprën penale në veprën penale të *“Keqpërdorimit të besimit”*.
63. Gjykata përsëritë përmbajtjen e paragrafit 1 të nenit 438 të KPPRK ku përcaktohet se kur Gjykata Supreme konstaton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, e njëjta merr aktgjykim me të cilin: (i) ndryshon vendimin e formës së prerë; (ii) në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; si dhe (iii); kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.
64. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk pretendon që nuk ka mundur të ndërtojë mbrojtjen e saj kundër veprës penale të *“Mashtrimit”*, për të cilën është ndjekur penalisht para gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, por pohon se nuk ka mundur të paraqesë argumentet e saj kundër veprës penale të *“Keqpërdorimit të besimit”*, për të cilën është dënuar pasi që Gjykata Supreme ka rikualifikuar atë.
65. Gjykata vëren se sipas paragrafit 1 të nenit 438 të KPPRK, Gjykata Supreme në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka të drejtë që të ndryshojë vendimin e formës së prerë, në kuptimin që sipas arsytimit të saj, e njëjta ka vlerësuar se vepra penale e *“Keqpërdorimit të besimit”* i përshtatet më shumë rrethanave faktike të rastit konkret, për të cilat konstaton se *“[...] përmes arsytimit të gjykatës së shkallës së dytë është paraqitur pasqyrë e qartë e rastit dhe gjithashtu janë vlerësuar dhe analizuar secila provë veç e veç dhe në tërësinë e tyre, dhe duke paraqitur arsyetim të plotë përkitazi me secilën provë të administruar nga gjykata e shkallës së parë.”*
66. Në rrethanat e rastit konkret, rezulton se parashtruesit të kërkesës nuk i është pamundësuar që të paraqesë argumentet kundër veprës penale të *“Mashtrimit”* për shkak se deri kur vendimi ka marrë formën e prerë, parashtruesi i kërkesës është ndjekur penalisht për këtë veprë penale dhe ka mundur të ndërtojë mbrojtjen e tij kundër të njëjtës. Ndërsa, legjislacioni në fuqi lejon që Gjykata Supreme të ricilësojë veprën penale në procedurë penale gjatë përdorimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik.
67. Gjykata vë në pah se Gjykata Supreme është kompetente, ndër të tjera, të vendosë lidhur me kërkesën për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me paragrafin 2 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK, ky mjet i jashtëzakonshëm

juridik nuk është i lejuar kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Për pasojë, nuk ekziston ndonjë instancë tjetër për të ushtruar të drejtën për ankesë apo mjet tjetër juridik.

68. Thënë këtë, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar argumente dhe dëshmi se si parimi i barazisë së armëve është shkelur gjatë procedurës penale në kuptimin e mohimit të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në parimet e elaboruara si më lart. Po ashtu, sipas legjislacionit në fuqi, nuk ekziston mjet juridik, përveç mjetit të jashtëzakonshëm të cilin tashmë parashtruesi i kërkesës e ka konsumuar për t'u ankuar kundër Akgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
69. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që do të arsyetonte konstatimin se janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si dhe me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e tij për shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe të drejtës për mjete juridike janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në *"mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"* ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 3 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

III. Përkitazi me pretendimet për divergjencën në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe të Apelit, si dhe shkeljen e neneve 3, 24 dhe 31 të Kushtetutës

70. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e parimit të sigurisë juridike në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës dhe shkelje të barazisë para ligjit, të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë parashtruesi i kërkesës vetëm ka cekur se: *"Gjykata Supreme ashtu edhe Gjykata e Apelit kanë vendosur për raste të ngjashme si të paditesit duke i ndryshuar ato, me ç'rast Gjykatat e rregullta kanë krijuar qëndrime të ndryshme për raste të ngjashme si të paraqitësit të kësaj kërkesë dhe me këtë edhe kanë krijuar pasiguri juridike, andaj edhe në kuptim të kësaj të dënuar in e ka vënë në pozitë të pabarabarta para ligjit në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës së Kosoves pasi që të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabarte ligjore, pa diskriminim. Me çka kemi shkelje të të drejtave të njeriut edhe në kuptim të Neni 31 pasi që çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike [...]."*
71. Gjykata vëren se në thelb parashtruesi i kërkesës ngrit çështjen e parimit të sigurisë juridike në kontekst të mungesës së konsistencës, përkatësisht divergjencës së praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe barazisë para ligjit në kuptim të neneve 3 dhe 24 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata thekson se lidhur me këto pretendime, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar vendime gjyqësore që dëshmojnë vendosjen ndryshe të gjykatave të rregullta në raste të ngjashme, përkatësisht nuk ka arritur të dëshmojë se ekziston divergenca në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme.
72. Gjykata, në këtë kontekst thekson se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih rastet e Gjykatës KI163/18, parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar

më lart, paragrafi 85, dhe KI124/20 parashtrues MuhamedAli Ceysülmedine, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42).

73. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me ekzistimin e divergjencës në praktikë gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe asaj të Apelit, si dhe për shkelje të neneve 3, 24 dhe 31 të Kushtetutës janë pretendime “*të pambështetura apo paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (d) të Rregullores së punës.

Përfundim

74. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse pretendimet e tij:
- I. Përkitazi me parashkrimin e veprës penale, gjegjësisht, shkeljen e neneve 31 dhe 33 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 dhe 7 të KEDNJ-së janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, pretendime të cilat bien në kategorinë e pretendimeve të “*shkallës së katërt*”, siç përcaktohet me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së Punës;
 - II. Përkitazi me shkeljen e parimit të barazisë së armëve, si dhe neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së janë qartazi të pabazuara në “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, siç është përcaktuar me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së Punës; dhe
 - III. Përkitazi me ekzistimin e divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme dhe të Apelit, si dhe shkeljen e neneve 7, 24 dhe 31 të Kushtetutës, janë të papranueshme si “*të pambështetura apo paarsyetuara*”, siç është përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

75. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon caktimin e masës së përkohshme, përkatësisht kërkon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit të tij.
76. Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parashikon se:
- “1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të riparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.
2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.”*
77. Gjykata në rastin konkret ka shpallur kërkesën të papranueshme në pajtim me rregullin 39 (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës.
78. Rrjedhimisht, Gjykata refuzon kërkesën për caktimin e masës së përkohshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (d) dhe (2), 57 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 7 mars 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani